

VENDIM
Nr.684, datë 25.8.2010

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT “MASTER I NIVELIT TË PARË”, NË
FAKULTETIN E SHKENCAVE TË EDUKIMIT, NË UNIVERSITETIN
“ALEKSANDËR XHUVANI”, ELBASAN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26 e 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI :

1.Hapjen, në fakultetin e shkencave të edukimit të universitetit “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, të programeve të studimit të ciklit të dytë “Master i nivelit të parë”, në:

- a)“Punonjës social me fëmijët dhe familjen”;
- b)“Psikolog në institucione”.

2.Programet e studimit “Master i nivelit të parë” realizohen me 60 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është një vit akademik.

3.Programet e studimit ta fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2010-2011.

4.Në përfundim të programeve të studimit lëshohen diplomat “Master i nivelit të parë”, MNP, në:

- a)“Punonjës social me fëmijët dhe familjen”;
- b) “ Psikolog në institucione”.

5.Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i universitetit “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, pa efekte buxhetore shtesë.

6.Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha